

# KARTA E APOSTOLLIT PAVEL MBË ROMANETE

## Krye 1

<sup>1</sup> Pavli, shërbëtuar i Jisu Krishtit, i-thërritur' apostoll, i-ndarë për **të lëçitur'** ungjillin e Perëndisë, <sup>2</sup> (Që qe zotuarë që përpara me anë të profitërvet të ti ndë shkronjat të-shënjtëruara,) <sup>3</sup> për të Birin' e ti Jisu Krishtinë, Zotinë t'ënë, i-cili pas mishit lindi nga far' e Dhavidhit, <sup>4</sup> **Edhe** pas frymës' së shënjtërisë udëftye Bir Perëndie me fuqi, me anë të të-ngjallurit **të ti** prej së-vdekurish; <sup>5</sup> Me anë të të-cilit muarmë hir e apostoli për emërin' e ati, që të bindenë ndë besët gjithë kombetë; <sup>6</sup> Ndër mest të të-cilëvet jeni edhe ju të-thërriturë të Jisu Krishtit; <sup>7</sup> Mbë gjithë ju që jeni ndë Romë, të-dashurë të Perëndisë, të-thërriturë shënjtorë, hir **qoftë** mbë ju edhe paqtim prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.

<sup>8</sup> Më përpara i falem ndersë Perëndisë t'im me anë të Jisu Krishtit për gjithë ju, sepse besa juaj zihetë n'gojë mbë gjithë botënë; <sup>9</sup> Sepse dëshmimtari im është Perëndia, të-cilit i shërbenj me shpirtinë t'im ndë ungjillt të Birit t'ati, se pa pushim u kujtonj juve, <sup>10</sup> Dyke luturë gjithënjë ndë të-falurat t'ime, që të dojë Perëndia ndonjë herë të m'a bënë mbarë të vinj tek ju. <sup>11</sup> Sepse kam shumë mall t'u shoh juve, që t'u ap ndonjë dhurëti shpirtërie që të forcohi; <sup>12</sup> Edhe këjo është të ngushllonem bashkë me ju me anë të besës' së-bashkëtë, s'uajsë edhe s'imesë.

<sup>13</sup> Edhe nukë dua të mos e dini, o vëllezër, se shumë herë e vura ndër mëntt të vinj tek ju, (po undaluashë gjer ndashti,) që të kem ndonjë pemë edhe ndër mest t'uaj, sikundrë edhe ndër mest të kombevet të-tjerë. <sup>14</sup> Jam detuar mbë Grekër e mbë varvarë, mbë të-ditur' e mbë të-paditurë; <sup>15</sup> Kështu, sa varetë nga unë, jam i-gatishim të lëçis ungjillinë edhe ndër ju që jeni ndë Romë.

<sup>16</sup> Sepse nukë kam turp për ungjillin' (e Krishtit); sepse është fuqi Perëndie për shpëtim mbi cilinëdo që beson, mbë Judhenë më parë, edhe mbë Grekunë **më pastaj**; <sup>17</sup> Sepse me anë t'ati sbulonetë drejtëri' e Perëndisë prej bese mbë besë, sikundrë është shkruarë, "I-drejti prej bese dotë rronjë."

<sup>18</sup> Sepse zëmërim Perëndie sbulonetë prej qielli mbi çdo pabesëri e paudhëri të njerësvet, që mbanjënë të-vërtetënë ndë paudhëri. <sup>19</sup> Sepse çdo që munt të dijë njeriu për Perëndinë është e-çfaqurë ndër ata; sepse Perëndia u'a çfaqti atyreve. <sup>20</sup> Sepse të-padukurat' e ati, fuqia e ati e-përjetëshme edhe hieria, që-kur-se ubë bota, shihenë kthjellëtë dyke umarrë me mënt me anë t'atyreve që janë bërë, kaqë sa ata të mos kenë seç të thonë. <sup>21</sup> Sepse, ndonëse e njohnë Perëndinë, nuk' e lavdruanë si Perëndi, as nuk' i ufalné ndersë; po ubënë të-kotë ndë të-menduarat të tyre, edhe uerrësua zëmër' e atyre e-pakupëtuarshime. <sup>22</sup> Dyke thënë, se janë të-mëncim, umarruanë; <sup>23</sup> Edhe ndërruanë lavdin' e të-pavdjerit Perëndi mbë shëmbëllesë fytyre njeriu të-vdjershim, e shpesësh, e katrëkëmbësesh e shtërpinjsh.

<sup>24</sup> Përandaj edhe i dha Perëndia ata ndë ndyrësirë me anë të dëshërimevet të zëmëravet t'atyre, që të çnderonenë trupat' e atyre ndër mest t'atyre. <sup>25</sup> Të-cilëtë ndërruanë të-vërtetën' e Perëndisë ndë gënjeshtërë, edhe nderuan' e adhuruanë krijesënë më tepërë se Krijetarinë, i-cili është i-bekuarë për gjithë jetënë. <sup>26</sup> Përandaj Perëndia i dha ata ndë dëshërime çnderimi; sepse edhe femërat' e atyre ndërruanë të-përdoruritë sipas naturësë ndë **të-përdorurë që është** kundrë naturësë; <sup>27</sup> Gjithashtu edhe meshkujtë lanë të-përdorurit' e femërësë si pas naturësë, e udoqnë ndë dëshërimt të tyre njëri me tjetrinë, dyke punuarë turpje

meshkuj mbë meshkuj, e dyke marrë ndë vetëhet të tyre çpägimnë që duhej të kobimit të tyre. <sup>28</sup> Edhe sikundrë nukë deshnë të njohënë Perëndinë, Perëndia i dha ata ndë një mëndje të-prishurë, që të bënjënë ato që nukë ka hie **të bënenë**; <sup>29</sup> Sepse ata janë plot me çdo farë paudhërie, kurvërie, dinakërie, lakmimi, ligësie; mbushurë me cmir, me vrasje, me qartë, me kobim, me poshtëri; <sup>30</sup> Asish që pishhtëllinjënë, asish që përflasënë, asish që e kanë cmir Perëndinë, asish që shanjënë, madhështorë, krye-lartë, asish që çpifnjënë të-këqia, të-pabindurë te prindëritë, <sup>31</sup> Të-çmëndurë, asish që s'mbanjënë fjalëtë që kanë lidhurë, të-padhëmçurë, të-papajtuarshim, të-papërdëlljershim; <sup>32</sup> Të-cilëtë, ndonëse njohënë drejtërin' e Perëndisë, se ata që punonjënë të-tillatë vëjenjënë për vdekje, jo vetëm' i bënjënë ato, po edhe gjenjënë pëlqim mb'ata që i punonjënë.

## Krye 2

<sup>1</sup> Përandaj s'munt të drejtëronjç vetëhenë, o njeri, cilido që të jesh ti që gjykon; sepse mb'atë që gjykon tjetërinë, dënon vetëhenë t'ënde; sepse ti që gjykon gjithato punon. <sup>2</sup> Edhe e dimë, se gjyqi i Perëndisë është me të-vërtetë kundr' atyreve që punonjënë të-tillatë. <sup>3</sup> Edhe mendon këtë ti, o njeri që gjykon ata që punonjënë të-tillatë, edhe që i bën ato **edhe vetë**, se ke për të shpëtuarë nga gjyqi i Perëndisë? <sup>4</sup> Apo bën për asgjë pasjen' e mirësis' s'ati e të durimit e të zëmërës' së-gjerë, edhe nuk' e di, se mirësi' e Perëndisë të bje ty ndë pendim? <sup>5</sup> Po për ashpërimnë t'ënt edhe për zëmërën' e-papenduarë mbleth mbë vetëhenë t'ënde zëmërim për ndë ditët të zëmërimit e të sbulesës' së gjyqit të-drejtë të Perëndisë, <sup>6</sup> I-cili dot'j'a çpaganjë gjithësicilit pas punëvet t'ati; <sup>7</sup> Atyreve që kërkonjënë me durim ndë punë të-mirë lavdi e nder e pavidjerje **dot'u apë** jetë të-përjetëshme; <sup>8</sup> Po mb'ata që grindenë edhe nuk' i bindenë së vërtetësë, po i bindenë paudhërisë, dotë jetë zëmërim e zëmëratë, <sup>9</sup> Hidhërim edhe shtrëngim mbë çdo shpirt njeriu që punon të-ligënë, Judheu më parë edhe **pastaj** Greku; <sup>10</sup> Po lavdi e nder e paqtim mbë cilinëdo që punon të-mirënë, mbë Judhenë më parë edhe **pastaj** mbë Grekunë. <sup>11</sup> Sepse te Perëndia s'ka të-mbajturë anë; <sup>12</sup> Se-pse sa fëjyenë pa nom, pa nom edhe dotë vdirenë; edhe sa fëjyenë ndënë nom, me nom dotë gjykonenë, <sup>13</sup> (Sepse nukë janë të-drejtë përpara Perëndisë ata që dëgjonjënë nomnë, po ata që mbushnjënë nomnë dotë drejtëronenë. <sup>14</sup> Sepse kur gjëndarëtë që s'kanë nom, prej nature bënjënë punët' e nomit, këta, ndonëse s'kanë nom, janë vetë nom ndë vetëhet të tyre; <sup>15</sup> Të-cilëtë dëftenjënë punën' e nomit të-shkruarë ndë zëmërat të tyre, sepse kanë ndërgegjen' e tyre dyke dëshmuarë bashkë me ata, edhe mendimetë dyke përfolurë a edhe dyke drejtëruarë njëri tjetërinë;) <sup>16</sup> Mb'atë ditë, kur dotë gjykonjë Perëndia të-fshehurat' e njerësvet me anë të Jisu Krishtit, pas ungjillit t'im.

<sup>17</sup> Na ti quhesh Judhe, edhe prëshesh ndë nomt, edhe mburresh mbë Perëndinë, <sup>18</sup> Edhe njeh dashurimn' **e ati**, edhe çquan ato që ndanjënë, sepse mësonesh prej nomit; <sup>19</sup> Edhe ke besim mbë vetëhenë t'ënde, se je udhëheqës i të-verbërvet, drit' e atyreve që janë nd'errësirë, <sup>20</sup> Ndreqës i të-marrërvet, mësonjës i foshnjavet, **edhe** se ke shëmbëllën' e diturisë e të së-vërtetësë ndë nomt. <sup>21</sup> Ti pra që mëson tjetërinë, vetëhenë t'ënde nuk' e mëson? ti, që lëçit të mos vjedhënë, vjeth? <sup>22</sup> Ti që thua të mos kurvëronjënë, kurvëron? ti që mërzit idhujtë, vjeth gjë kishë? <sup>23</sup> Ti që mburresh mbë nomnë, çpërnderon Perëndinë dyke shkëlurë nomnë? <sup>24</sup> Sepse "emëri i Perëndisë për juve shahetë ndër kombet", sikundrë është shkruarë.

<sup>25</sup> Sepse rrethpresja bën dobi, ndë mbushç nominë; po ndë shkelç nominë, rrethpresja jote ubë parrethpresje. <sup>26</sup> Ay pra që nuk' është i-rrethprerë ndë ruajtë porosit' e nomit, parrethpresja e ati a nukë dotë numëronetë rrethpresje? <sup>27</sup> Edhe ay që është i-parrethprerë ndë trupt edhe mbush nominë dotë të gjykonjë ty që

ke shkronjën **e nomit** edhe rrethpresjenë, e shkel nominë. <sup>28</sup> Sepse nuk' është Judhe ay që është përjashta **Judhe**, as rrethpresje ajo që është për faqe ndë misht; <sup>29</sup> Po Judhe **është** ay që është përbërënda **Judhe**, edhe rrethpresje ajo e zëmëresë, që **është** pas frymësë e jo pas shkronjesë, i të-cilit **Judhe** nderi është jo prej njerësvet, po prej Perëndisë.

### Krye 3

<sup>1</sup> Ç'ka më tepërë pra Judheu? a cila është dobia e rrethprerjesë? <sup>2</sup> Shumë nga çdo anë. Më përpara, sepse fjalët' e Perëndisë u ubesuanë **Judhenjet**. <sup>3</sup> Sepse çë, ndë mos besuanë ca? mos dotë hethnjë poshtë besën' e Perëndisë pabesëria e atyreve? <sup>4</sup> Qoftë lark; po Perëndia qoft' i-vërtetë, edhe çdo njeri gënjeshtar, sikundrë është shkruarë, "Që të dalç i-drejtë ndë fjalët të tua, edhe të munç kur të gjykonesh."

<sup>5</sup> Po ndë dëften shtrëmbëria jonë drejtërin' e Perëndisë, ç'duhetë të themi? mos është i-shtrëmbërë Perëndia që bje zëmëratënë? (si njeri flas;). <sup>6</sup> Qoftë lark; sepse **atëhere** qysh dotë gjykonjë Perëndia botënë? <sup>7</sup> Sepse ndë qoftë se me anë të gënjeshtresë s'ime ushtua e-vërtet' e Perëndisë për lavdi t'ati, përse më unë gjykonem si fajtuar? <sup>8</sup> Edhe, (sikundrë shahemi, edhe sikundrë thonë ca, se neve themi,) përse të mos bëjmë të-ligatë, që të vinjënë të-miratë? Dënimi i të-këtillevët është i-drejtë.

<sup>9</sup> Çë pra? jemi neve më të-mirë **se gjëtarëtë**? pa fjalë jo; Sepse e treguamë më përpara, se edhe Judhenjtë edhe Grekëritë, të-gjithë janë ndënë faj; <sup>10</sup> Sikundrë është shkruarë, "Se s'ka të-drejtë as një; <sup>11</sup> S'ka as një që kupëton; s'ka as një kërkon Perëndinë. <sup>12</sup> Të-gjithë duallë jashtë udhësë, bashkë ubënë të-pavëjyerë; s'ka kush të bënë të-mirë; s'ka as një" <sup>13</sup> "Varr i-hapëtë është gurmaz' i atyre; me gjuhët' e tyre flisninë kobime;" "verër aspidhash është ndënë buzët t'atyre" <sup>14</sup> "Goj' e të-cilëvet është plot me mallëkim e me hidhërim." <sup>15</sup> "Këmbët' e atyreve janë të-çpejta për të derdhurë gjak"; <sup>16</sup> "Të-shkretuar' e të-hequrë keq **është** ndëpër udhët t'atyreve; <sup>17</sup> Edhe udhë paqtimi nukë kanë njohurë." <sup>18</sup> "Nuk' është frikë Perëndie përpara syvet t'atyre".

<sup>19</sup> Edhe dimë se sa thotë nomi, u'a thot' atyre që janë ndënë nomt; që të thuretë çdo gojë, edhe gjithë bota të bënë të fajtove përpara Perëndisë. <sup>20</sup> Sepse prej punërash nomi s'ka për të dal' i-drejtë asndonjë mish përpara ati; sepse me anë të nomit njihetë faji.

<sup>21</sup> Po ndashti pa nom uçpërfaq drejtëria e Perëndisë, dyke umartirisurë prej nomit edhe prej profitërvet; <sup>22</sup> **Po**, drejtëria e Perëndisë me anë të besësë mbë Jisu Krishtinë ndër gjithë e mbi gjith' ata që besonjënë; sepse nukë ka **ndonjë farë** ndryshimi; <sup>23</sup> Sepse të-gjithë fëjyenë, edhe të-gjithëve u shteretë lavdia e Perëndisë; <sup>24</sup> Edhe dalënë të-drejtë dhurëti me anë të hirit t'ati, me anë të çpërblimit që është mbë Jisu Krishtinë; <sup>25</sup> Të-cilinë Perëndia e vuri që përpara **që të jetë** vegëlë çpërblimi me anë të besësë ndë gjakt t'ati, që të tregonjë drejtërin' e ti, për ndjesën' e fajevet që qenë bërë përpara, me anë të durimit të Perëndisë; <sup>26</sup> Që të tregojë drejtërin' e ti ndë këtë kohë, që të jet' ay i-drejtë, edhe të nxjerrë të-drejtë atë që i beson Jisujt. <sup>27</sup> Ku **është** pra të-mburriritë? U mbyll jashtë. Me cilinë nom? **me nomn' e** punëvet? Jo; po me nomin' e besësë.

<sup>28</sup> Kupëtojmë pra, se njeriu del i-drejtë me anë të besësë, pa punët' e nomit.

<sup>29</sup> Apo vetëm' i Judhenjet është Perëndia? e jo edhe i kombevet? Po, **është** edhe i kombet; <sup>30</sup> Sepse një është Perëndia që dotë nxjerrë të-drejtë rrethpresjenë prej besësë, edhe parrethpresjenë me anë të besësë. <sup>31</sup> Nominë pra hethmë poshtë me anë të besësë? Qoftë lark; po nominë vërtetojmë.

## Krye 4

<sup>1</sup> Ç'dotë themi pra se fitoj Avraami, ati ynë pas mishit?

<sup>2</sup> Sepse ndë dolli i-drejtë Avraami prej punëvet, ka mbë se të mburretë, po jo përpara Perëndisë. <sup>3</sup> Sepse ç'thotë shkronja? "Edhe i besoj Avraami Perëndisë, edhe i unumërua ati për drejtëri." <sup>4</sup> Edhe ati që punon paga nuk' i numëronetë si hir, po si detyrë; <sup>5</sup> Po ati që s'punon, edhe i beson ati që nxjer të-drejtë të-shtrëmbërinë, besa e ati numëronetë për drejtëri.

<sup>6</sup> Sikundrë edhe Dhavidhi e rrëfen të-lumëruarët' e ati njeriu, të-cilit Perëndia i numëron drejtëri pa punëra, **dyke thënë**: <sup>7</sup> "Lum ata, të-cilëvet u undjenë paudhëritë, edhe të-cilëvet u umbuluanë fajetë. <sup>8</sup> Lum ay njeri, të-cilit Zoti nukë dot' i numëronjë faj."

<sup>9</sup> Këta të-lumëruarë pra **thuhetë** vetëmë për ata që janë të-rrethprerë, apo edhe për ata që nukë janë të-rrethprerë? sepse themi se besa i unumërua Avraamit për drejtëri. <sup>10</sup> Si pra i unumërua? kur ishte i rrethprerë, apo kur ishte i-parrethprerë? Jo kur ishte i-rrethprerë, po kur ishte i-parrethprerë. <sup>11</sup> Edhe mori shënjën' e rrethpresjesë për vulë të drejtërisë që fitoj prej besësë që kishte, kur ishte i-parrethprerë, që të jet' ay atë i gjith' atyreve që besonjënë, kur janë të-parrethprerë, që t'u numëronetë edhe atyreve drejtëria; <sup>12</sup> Edhe atë i rrethpresjesë jo vetëmë mb'ata që janë të-rrethprerë, po edhe mb'ata që ecënjënë pas gjurmëvet të besës' s'atit t'ënë Avraam, kur qe i-parrethprerë.

<sup>13</sup> Sepse të-zotuarëtë mb'Avraamnë a mbë farën' e ati, se dotë jetë trashëgimtar' i botësë, nuk' **ubë** me anë të nomit, po me anë të drejtërisë që është prej besësë.

<sup>14</sup> Sepse ndë **janë** trashëgimtarë ata që janë prej nomit, besa është' e-sbrazëtë, edhe të-zotuarëtë ra poshtë. <sup>15</sup> Sepse nomi sjell zëmëratë; sepse ku s'ka nom, s'ka as të-dalë jashtë **nomit**. <sup>16</sup> Përandaj **trashëgimi ështëë** prej besësë, që **të jetë** dhurëti, **edhe** të-zotuarëtë të jetë të-siguarë mbë gjithë farënë, jo vetëmë mb'atë që është prej nomit, po edhe mb'atë që **është** prej besës' s'Avraamit, i-cili është atë i neve të gjithëve, <sup>17</sup> (Sikundrë është shkruarë, "Se të bëra atë të shumë kombeve,") përpara Perëndisë, të-cilit i besoj, edhe i-cili ep jetë të-vdekuret, edhe quan të-paqënatë si të-qëna. <sup>18</sup> Ay pa pasurë shpresë me shpresë besoj, se dotë bënej atë i shumë kombeve, sikundrë qe folurë, "Kësh-tu dotë jetë fara jote;"

<sup>19</sup> Edhe passi nuk' ishte i-dobëtë ndë besët, nuk' umendua, se ndashti trup' i ti ishte i-vdekurë, sepse ishte poshtë' e lart një qint vjeç, as të-vdekurit' e shtratit të Sarrësë;

<sup>20</sup> As ndë të-zotuarët' të Perëndisë pat dyshim dyke mos besuarë, po uforcua ndë besët, dyke dhënë lavdi Perëndisë, <sup>21</sup> E dyke qënë i-bindurë, se atë që i uzotua Zoti është' i-zoti edhe t'a bënë. <sup>22</sup> Përandaj edhe i unumërua ati për drejtëri.

<sup>23</sup> Edhe nuk' ushkua vetëmë për atë, se i unumërua ati, <sup>24</sup> Po edhe për ne, ndë të-cilët dotë numëronetë, **për ne**, të-cilët' i besojm' ati që ngjalli prej së-vdekurish Jisunë, Zotinë t'ënë; <sup>25</sup> I-cili udha ndër duar për fajetë t'anë, edhe ungjall për të-drejtëruarëtë t'ënë.

## Krye 5

<sup>1</sup> Si duallmë pra të-drejtë prej bese, kemi paqtim me Perëndinë me anë të Zotit t'ënë Jisu Krisht, <sup>2</sup> Prej të-cilit kemi edhe të-hyrëtë me anë të besësë ndë këtë hir, ndë të-cilët qëndrojmë; edhe mburremi mbë shpresën' e lavdis' së Perëndisë.

<sup>3</sup> Edhe jo vetëmë **këjo**, po edhe mburremi mbë shtrëngimetë, dyke diturë, se shtrëngimi sjell durim, <sup>4</sup> Edhe durimi provë, edhe prova shpresë; <sup>5</sup> Edhe shpresa nukë turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhurë ndë zëmërat t'ona me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë që na është dhënë. <sup>6</sup> Sepse kur ishimë neve edhe po të-sëmurë, Krishti vdiq ndë kohët **që qe urdhëruarë** për të-pabesëtë. <sup>7</sup> Sepse

mezi për njeri të-drejtë do ndonjë të vdesë; sepse për të-mirinë mbase edhe kuxon ndonjë të vdesë. <sup>8</sup> Po Perëndia dëften dashurin' e ti mbë ne, sepse tek ishimë neve edhe po fajtorë, Krishti vdiq për ne; <sup>9</sup> Shumë më tepërë pra, si duallmë të-drejtë ndashti me anë të gjakut t'ati, dotë shpëtojmë nga zëmërata me anë t'ati. <sup>10</sup> Sepse, ndë qoftë se kur ishim' armiç upaqtuamë me Perëndinë me anë të vdekjes' së Birit t'ati, shumë më tepërë passi upaqtuamë dotë shpëtojmë me anë të jetës' s'ati.

<sup>11</sup> Edhe jo vetëmë **këtë**, po edhe mburremi mbë Perëndinë me anë të Zotit t'ënë Jisu Krisht, me anë të të-cilit muarmë ndashti të-paqëtuarëtë.

<sup>12</sup> Përandaj sikundrë me anë të një njeriu hyri faji ndë botët, edhe me anë të fajit vdekja, edhe kështu shkoj vdekja mbi gjithë njerëzit, sepse që të-gjithë fëjyenë; <sup>13</sup> (Sepse **edhe** gjer ndë kohët të nomit faji ishte ndë botët, po faj nukë numëronetë, kur s'ka nom. <sup>14</sup> Po vdekja mbretëroj që prej Adhamit e gjer te Moisiu edhe mb'ata që nukë fëjyenë sipas shëmbëllës' së të-fëjyerit t'Adhamit, i cili ishte forma e ati që dotë vinte.

<sup>15</sup> Po jo si faji, kështu edhe dhurata; sepse ndë qoftë se për fajin' e njëj vdiqnë të-shumëtë, shumë më tepërë hiri i Perëndisë edhe dhurata me anë të hirit të një njeriu, të Jisu Krishtit, tepëroj mbë të-shumëtë.

<sup>16</sup> Edhe dhurata nuk' është si **puna që ubë** me anë të njëj që fëjeu; sepse faji prej njëj **ubë** për dënim **të të-gjithëve**, po dhurëtia **ubë** për të-drejtëruarë prej shumë fajesh. <sup>17</sup> Sepse ndë qoftë se prej fajit të njëj mbretëroj vdekja me anë të njëj, shumë më tepërë ata që marrënë tepëricën' e hirit edhe të dhurëtis' së drejtërisë dotë mbretëronjënë ndë jetët me anë të njëj, të Jisu Krishtit.)

<sup>18</sup> Sikundrë pra me anë të një faji **erdhi** dënim mbë gjithë njerëzitë, kështu edhe me anë të një drejtërie **erdhi** mbë gjithë njerëzitë të-drejtëruarë për jetë. <sup>19</sup> Sepse sikundrë me anë të të-mos-dëgjuarit të një njeriu ubënë fajtorë të-shumëtë, kështu edhe me anë të të-dëgjuarit të njëj dotë bënënenë të-drejtë të-shumëtë.

<sup>20</sup> Edhe nomi hyri ndër mest, që të tepëronjë faji. Edhe ku tepëroj faji, fort tepërë tepëroj hiri; <sup>21</sup> Që, sikundrë mbretëroj faji me anë të vdekjesë, kështu edhe hiri të mbretëronjë me anë të drejtërisë për jetë të-përjetëshme, me anë të Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.

## Krye 6

<sup>1</sup> Ç'të themi pra? të qëndrojmë ndë fajt, që të tepëronjë hiri?

<sup>2</sup> Mos dhëntë Zoti; neve që vdiqmë ndë fajt, qysh dotë rrojmë më nd'atë?

<sup>3</sup> A nuk' e dini, se sa upagëzuamë mbë Jisu Krishtinë, mbë vdekjen' e ati upagëzuamë? <sup>4</sup> Uvarruamë pra bashkë me atë me anë të pagëzimit ndë vdekjet, që, sikundrë Krishti ungjall prej së-vdekurish me anë të lavdis' s'Atit, kështu edhe neve të ecëjmë ndë jetë të-re. <sup>5</sup> Sepse ndë ubëmë një bimë bashkë me atë pas shëmbëllimit të vdekjes' s'ati, dotë jemi edhe pas **shëmbëllimit** të të-ngjallurit; <sup>6</sup> Dyke diturë këtë, se njeriu ynë i-vjetërë ukryqëzua bashkë **me atë**, që të prishetë trupi i fajit, që të mos i shërbejmë më fajit. <sup>7</sup> Sepse ay që vdiq ulirua nga faji. <sup>8</sup> Edhe ndë vdiqmë bashkë me Krishtinë, besojmë se edhe dotë rrojmë bashkë me atë; <sup>9</sup> Sepse e dimë se Krishti, që ungjall prej së-vdekurish, nukë vdes më; vdekja nuk' e pushton më atë. <sup>10</sup> Sepse atë që vdiq, vdiq një herë për fajinë; po atë që rron, rron mbë Perëndinë. <sup>11</sup> Kështu edhe ju numëro-e-ni vetëhenë t'uaj, se jeni të-vdekurë për fajinë, po të-gjallë mbë Perëndinë, me anë të Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.

<sup>12</sup> Letë mos mbretëronjë pra faji ndë trupit t'uajt të-morçim, që t'i bindeni ati pas dëshërimevet t'ati; <sup>13</sup> As mos tregoni anët' e trupit t'uaj armë shtrëmbërie ndë fajt; po tregoni vetëhenë t'uaj te Perëndia si të-gjallë prej së vdekurish, edhe anët' e **trupit** t'uaj armë drejtërie te Perëndia. <sup>14</sup> Sepse faji nukë dot' u pushtonjë juve; sepse nukë jemi ndënë nom, po ndënë hir.

<sup>15</sup> Çë pra? të fëjëjmë, sepse nukë jemi ndënë nom, po ndënë hir? Zoti mos e dhëntë.

<sup>16</sup> Nuk' e dini, se mb'atë që tregoni vetëhenë t'uaj shërbëtorë që t'i bindeni, jini shërbëtorë t'ati që i bindeni, a të fajit për vdekje, a të të-dëgjuarit për drejtëri? <sup>17</sup> Po i falemi ndersë Perëndisë, se ishitë **një herë** shërbëtorë të fajit, po **ndashti** ubinttë prej zëmëre ndë formët të mësimit që udha ndër ju. <sup>18</sup> Edhe si uliruatë nga faji, ubëtë shërbëtorë të drejtërisë. <sup>19</sup> Njerëzish po flas, për dobësirën' e mishit t'uaj. Sepse sikundër i bëtë anët' **e trupit** t'uaj shërbëtorë ndë ndyrësirët edhe ndë panomit për panominë, kështu ndashti bëni anët' **e trupit** t'uaj shërbëtorë ndë drejtërit për shënjtërim. <sup>20</sup> Sepse kur ishitë shërbëtorë të fajit, ishitë të-liruarë nga drejtëria. <sup>21</sup> Ç'farë peme pra kishit' atëhere nga ato punë, për të-cilatë ndashti kini turp? sepse e pastajmja e atyreve është vdekje. <sup>22</sup> Po ndashti që uliruatë nga faji, edhe ubëtë shërbëtorë te Perëndia, keni pemënë t'uaj për shënjtërim; edhe për funt jetë të-përjetëshme. <sup>23</sup> Sepse paga e fajit është vdekje, po dhurëtia e Perëndisë **është** jet' e-përjetëshme me anë të Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.

## Krye 7

<sup>1</sup> Apo nuk' e dini, o vëllezër, (sepse u flas **njerësve** që dinë nomnë,) se nomi ka pushtet mbi njerinë sa kohë rron? <sup>2</sup> Sepse gruaja e-martuarë është' e-lidhurë nga nomi me burrinë gjersa ky është' i-gjallë; po ndë vdektë burri, lironetë nga nomi i burrit. <sup>3</sup> Kur rron pra burri, ndë ubash-koftë me tjetërë burrë, dotë jetë kurvë; po ndë vdektë burri, është' e-liruarë nga nomi, që të mos jetë kurvë, ndë ubashkoftë me tjetërë burrë. <sup>4</sup> Përandaj, vëllezërit' e mi, edhe ju jeni të-vdekurë te nomi me anë të trupit të Krishtit, që të bashkoneni me tjetërë, me atë që ungjall prej së-vdekurish, që të bjëmë pemë te Perëndia. <sup>5</sup> Sepse kur ishimë ndë misht, dëshërimet' e fajevet, që ishinë me anë të nomit, punoneshinë ndër anët **të trupit** t'ënë, që të bjëmë pemë ndë vdekjet; <sup>6</sup> Po ndashti usgithmë nga nomi, passi vdiq ay prej të-cilit ishimë pushtuarë; që të punojmë pas frymës' së-re, e jo pas shkronjës' së-vjetërë.

<sup>7</sup> Ç'të themi pra? nomi **është** faj? Qoftë lark; po fajné nuk' e njoha, veç me anë të nomit; sepse edhe dëshërimnë nukë dot'a njihnjam, po të mos thoshte nomi, "Mos dëshërojsh." <sup>8</sup> Po faji dyke marrë çkak me anë të porosisë ngjalli tek unë çdo farë dëshërimi; sepse pa nomi faji është' i-vdekurë. <sup>9</sup> Edhe unë rronjam një herë pa nom; po kur erdhi porosia, faji ungjall përsëri, e unë vdiq; <sup>10</sup> edhe **kështu** porosia që udha për jetë, ajo ugjënt tek unë për vdekje. <sup>11</sup> Sepse faji, dyke marrë çkak me anë të porosisë, më gënjeu, edhe me anë t'asaj më vrau. <sup>12</sup> Përandaj nomi është' i-shënjtëruarë, edhe porosia e-shënjtëruar' edhe e-drejtë edhe e-mirë.

<sup>13</sup> Ajo gjë pra që është' e-mirë ubë tek unë vdekje? Qoftë lark; po faji, që të duketë faj, me anë të së-mirësë pruri tek unë vdekje, që me anë të porosisë faji të bënëte fort tepërë fajtuar.

<sup>14</sup> Sepse e dimë se nomi është' i-frymëtë; po unë jam i-mishtë, shiturë ndënë fajinë. <sup>15</sup> Sepse atë që punonj nuk' e njoh; sepse nukë bënj atë që dua, po bënj atë që kam cmir. <sup>16</sup> Edhe ndë bënj atë që nukë dua, jam mbë një fjalë me nomnë, se është' i-mirë. <sup>17</sup> Po ndashti nuk' e bënj më unë këtë, po faji që rri tek unë. <sup>18</sup> Sepse e di, se nukë rri tek unë, (do-me-thënë ndë misht t'im,) gjë e-mirë; sepse të-dashuritë gjendetë tek unë, po të punonj të-mirënë nuk' e gjenj; <sup>19</sup> Sepse nukë bënj të-mirënë që dua **të bënj**, po të-keqenë që nukë dua, këtë punonj. <sup>20</sup> Edhe ndë bënj unë atë që nukë dua, më nuk' e punonj un' atë, po faji që rri tek unë. <sup>21</sup> Gjenj pra këtë nom, se kur dua unë të bënj të-mirënë, gjendetë tek unë e-liga. <sup>22</sup> Sepse pas njeriut të-përbrëndësh gjen shëfrim mbë nomn' e Perëndisë; <sup>23</sup> Po shoh një tjetërë nom ndër anët **të trupit** t'im që lufton kundër nomit të mëndjes' s'ime, edhe më skllavos ndë nomt të fajit që është' ndër anët **të trupit** t'im. <sup>24</sup> Mjerë unë njeriu! kush dotë

më shpëtonjë nga ky trup i vdekjesë? <sup>25</sup> I falem nderisë Perëndisë me anë të Zotit t'ënë Jisu Krisht. Kështu pra unë me mëndjenë i shërbenj nomit të Perëndisë; po me mishinë **i shërbenj** nomit të fajit.

## Krye 8

<sup>1</sup> Ndashti pra s'ka ndonjë dënim për ata që janë mbë Jisu Krishtinë, që nuk' ecënjënë pas mishit, (po pas Frymësë). <sup>2</sup> Sepse nomi i Frymës' së jetësë mbë Jisu Krishtinë më liroj prej nomit të fajit edhe prej vdekjesë. <sup>3</sup> Sepse atë që s'muntte të bënte nomi, sepse ishte i-dobëtë me anë të mishit, Perëndia dyke dërguarë Birin' e ti me shëmbëllim mishi fajtuar, edhe për faj, dënoj fajinë ndë misht; <sup>4</sup> Që të mbushetë drejtërim' i nomit mbë ne që nukë ecëjmë pas mishit, po pas Frymësë. <sup>5</sup> Sepse ata që rronjë në pas mishit, kanë ndër mëntt punët' e mishit; po ata **që rronjë në** pas Frymësë **kanë ndër mëntt** punët' e Frymësë. <sup>6</sup> Sepse mendimi i mishit është vdekje, po mendimi i Frymësë **është** jetë edhe paqtim. <sup>7</sup> Sepse mendim' i mishit është' armiqësi te Perëndia; sepse ndë nomt të Perëndisë nukë bindetë, po as nukë munt. <sup>8</sup> Edhe sa janë të mishit nukë muntjnë në t'i pëlqenjë Perëndisë.

<sup>9</sup> Po ju nukë jeni të mishit, po të Frymësë, ndë qoftë se rri Frym' e Perëndisë ndër ju. Po ndë mos ka ndonjë Frymën' e Krishtit, ky nuk' është i ati. <sup>10</sup> Po ndë është Krishti ndër ju, trupi është' i-vdekurë për fajinë; po fryma është jetë për drejtërimë. <sup>11</sup> Po ndë rri ndër ju Frym' e ati që ngjalli Jisunë prej së-vdekurish, ay që ngjalli Krishtinë prej së-vdekurish dot'u apë jetë edhe trupavet t'uaj të-morçim, me anë të Frymës' së ti që rri ndër ju.

<sup>12</sup> Kështu pra, o vëllezër, jemi detorë jo të mishit, që të rrojmë pas mishit. <sup>13</sup> Sepse ndë rrofshi pas mishit, kini për të vdekurë, po ndë vrafshi punët' e trupit me anë të Frymësë, dotë rroni. <sup>14</sup> Sepse sa hiqenë prej Frymës' së Perëndisë, këta janë bij të Perëndisë.

<sup>15</sup> Sepse s'keni marrë frymë robërie, që të keni frikë përsëri, po keni marrë frymë birërie, me anë të së-cilësë thërresmë, Avva, o Atë. <sup>16</sup> Vetë Fryma dëshmon bashkë me frymën t'ënë, se jemi bij Perëndie. <sup>17</sup> Edhe ndë **jemi** bij, **jemi** edhe trashëgimtarë; trashëgimtarë të Perëndisë, edhe trashëgimtarë bashkë me Krishtinë, ndë vuafshimë bashkë me atë, që edhe të lavdurohemi bashkë me atë.

<sup>18</sup> Sepse unë mendonem, se të-vuarat' e së-tanishmësë kohë nukë vëjenjë në të mbarasonenë me lavdinë që dotë sbulonetë ndër ne. <sup>19</sup> Sepse të-priturit' e-math të kriesësë pret të-çpërfaqurit' e bijvet të Perëndisë. <sup>20</sup> Sepse kriesa uvu ndënë urdhër të kotësirësë, jo dyke dashurë, po për atë që e vuri ndënë urdhër, <sup>21</sup> Me shpresë se edhe vetë kriesa dotë lironetë nga robëria e prishjesë, e **të vejë** ndë lirit të lavdis' së bijvet të Perëndisë. <sup>22</sup> Sepse e dimë se gjithë kriesa psherëtin e ka të-dhëmbura bashkë gjer ndashti. <sup>23</sup> Edhe jo vetëm' **ajo**, po edhe ata që kanë pemën' e-parë të frymësë, edhe neve vetë psherëtimë ndër vetëhet t'ënë, dyke priturë birërinë, **do-me-thënë** çpërblimë e trupit t'ënë. <sup>24</sup> Sepse me shpresënë shpëtuamë; po shpresa që shihetë nuk' është shpresë, sepse për atë **gjë** që e sheh njeriu përse edhe të shprenjë? <sup>25</sup> Po ndë shprejmë për atë **gjë** që nuk' e shohëmë, me anë të durimit e presëmë.

<sup>26</sup> Gjithashtu edhe Fryma na ndih ndë dobësitat t'ona, sepse nukë dimë për ç'farë gjeje të falemë sikundër duhetë, po vetë Fryma lutetë për ne me psherëtimë të-pazëshme. <sup>27</sup> Edhe ay që vëzhgon zëmëratë e di seç **është** mendimi i Frymësë, se pas **dashurimit** të Perëndisë lutetë për shënjtorëtë.

<sup>28</sup> Edhe e dimë se të-gjitha u ndihnjënë për të-mirë atyreve që duanë Perëndinë, atyreve që janë thirrurë pas dashurimit t'ati. <sup>29</sup> Sepse sa njohu që përpara, këta edhe i ndau që përpara që të jenë si-një-një nga forma me fytyrën' e Birit të ti, që të

jet' ay i parëlindurë ndër shumë vëllezër. <sup>30</sup> Edhe sa ndau që përpara, këta edhe i thirri; edhe sa thirri, këta edhe i drejtëroj; edhe sa drejtëroj, këta edhe i lavduroj.

<sup>31</sup> Ç'të themi pra për këto **punë**? Ndë është Perëndia bashkë me ne, kush **dotë jetë** kundrë nesh? <sup>32</sup> Sepse ay që nukë kurseu Birin' e ti, po e dha ndër duar për gjithë ne, qysh nukë dotë na falnjë neve të-gjitha bashkë me atë? <sup>33</sup> Cili dotë përflasë të-zgjedhurit' e Perëndisë? Perëndia **është** ay që drejtëron. <sup>34</sup> Cili dotë jet' ay që dënon? Krishti **është** ay që vdiq, po edhe më tepër' ay që ungjall, i-cili edhe është mbë të-djathhtë të Perëndisë, i-cili edhe lutetë për ne. <sup>35</sup> Cili dotë na ndanjë nga dashuria e Krishtit? Shtrëngim, a ngushtim, a vdekje, a zi, a të-sveshurë, a rrëzik, a thikë? <sup>36</sup> (Sikundrë është shkruarë, "Se për tynë vritemi gjithë ditënë; unumëruamë posi dhën për të therurë.") <sup>37</sup> Po mbë gjithë këto neve dalëmë me tepërë se mundës me anë t'ati që na deshi. <sup>38</sup> Sepse më është mbushurë mëndja se as vdekje, as jetë, as ëngjëj, as pushtete, as fuqira, as ato që janë ndashti, as ato që kanë për të ardhurë, <sup>39</sup> As lartësirë, as thellësirë, as ndonjë tjetërë kriese, dotë muntnjë të na ndanjë nga dashuria e Perëndisë që është mbë Jisu Krishtinë Zotinë t'ënë.

## Krye 9

<sup>1</sup> Të-vërtetë them mbë Krishtinë, nukë gënjenj, (edhe **mbë këtë** ep dëshmim bashkë me mua dërgjegja ime me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë,) <sup>2</sup> Se kam hidhërim të-math edhe pa pushim të-dhëmburë ndë zëmëret' t'ime. <sup>3</sup> Sepse unë vetë donjam të-ishnjam i-mallëkuarë, **i-ndarë**, nga Krishti për vëllezërit' e mi, për farëfisasit' e mi pas mishit; <sup>4</sup> Të-cilët janë Israilitë, të të-cilëvet **është** birëria, edhe lavdia, edhe dhjathtë, edhe të-vënurit' e nomit, edhe adhurimi, edhe të-zotuarëtë; <sup>5</sup> Të të-cilëvet **janë** atëritë, edhe prej të-cilëvet lindi Krishti pas mishit, i-cili është përmbi të-gjitha Perëndi i-bekuarë për **gjithë** jetëtë. Amin.

<sup>6</sup> Po nukë munt të jetë që të ketë rënë poshtë fjal' e Perëndisë. Sepse gjithë sa janë prej Israilit, këta nukë janë Israil; <sup>7</sup> As sepse janë far' e Avraamit, **për këtë janë** të-gjithë bij t'ati; po "mbë Isaakunë dotë quhetë fara jote." <sup>8</sup> Do-me-thënë, bijt' e mishit, nukë **janë** këta bij të Perëndisë; po bijt' e të-zotuarit numëronenë për farë. <sup>9</sup> Sepse fjal' e të-zotuarit është këjo, "Mbë këtë kohë dotë vinj, edhe Sarra dotë ketë bir."

<sup>10</sup> Edhe jo vetëmë **këjo**, po edhe Reveka kur ugjënt me barrë prej një **burri**, prej Isaakut atit t'ënë; <sup>11</sup> (Sepse para se të lindinë **djemtë**, edhe para se të bëninë ndonjë **punë** të-mirë a të-ligë, që të mbetetë urdhëri i-parë i Perëndisë që është prej të-sgjedhuri, jo prej punësh, po prej ati që thërret,) <sup>12</sup> I utha asaj, "Se m'i-madhi dot'i shërbenjë më të-vogëlit;" <sup>13</sup> Sikundrë është shkruarë, "Jakovin' e desha, po Isafinë e pata cmir."

<sup>14</sup> Ç'të themi pra? Mos **ka** shtrëmbëri te Perëndia? Qoftë lark. <sup>15</sup> Sepse Moisiut i thotë, "Dotë përdëllenj atë që të përdëllenj, edhe dotë më dhëmbetë për atë që të më dhëmbetë." <sup>16</sup> Kështu pra **këjo** nuk' **është** prej ati që do, as prej ati që suletë, po prej Perëndisë që përdëllen. <sup>17</sup> Sepse shkronja i thotë Faraonit, "Se për këtë të ngrita, që të dëftenj mbë ty fuqinë t'ime, edhe që të rrëfenetë emëri im mbë gjithë dhenë." <sup>18</sup> Atë pra që do **t'e përdëllenjë**, e përdëllen; edhe atë që do **t'ashpëronjë**, e ashpëron.

<sup>19</sup> Dotë më thuash pra, Përse më gjen faj? cili munt të rrijë kundrë dashurimit t'ati? <sup>20</sup> Po cili je ti, o njeri, që i kundrëpërgjigjesh Perëndisë? Mos munt t'i thotë gatesa gatonjësit, Përse më bëre kështu? <sup>21</sup> Apo s'ka pushtet shtëmbari mbi baltënë, që të bënjë prej gjithati brumi një enë për nder, dhe një tjetërë për çnderim? <sup>22</sup> E çë, ndë Perëndia, dyke dashurë të-dëftenjë zëmëratën' **e ti**, edhe të bënjë të-njohurë fuqin' e ti, duroj me shumë zëmërë të-gjerë enë zëmërate që qenë



bërë për të humburë? <sup>23</sup> Edhe që të bënë të-njohurë pasjen' e lavdis' së tij mbi enë përdëllimi, të cilatë i bëri për lavdi, <sup>24</sup> Mbi ne, të-cilëtë edhe na thirri jo vetëmë prej Judhenjvet, po edhe prej kombevët?

<sup>25</sup> Sikundrë edhe ndë Osienë thotë, "Dotë quanj llaus t'im atë s'ka qënë llauzi im, edhe të-dashurë, të-mosdashurënë." <sup>26</sup> "Edhe dotë jetë nd'atë vënt, tek u është thënë atyreve, Nukë **jeni** ju llauzi im, atje dotë quhenë bij të Perëndis' së-gjallë."

<sup>27</sup> Edhe Isaia bërtet për Israilinë, "**Edhe** ndë qoftë numëri e bijvet të Israilit posi rëra e detit, e-mbetura e atyre dotë shpëtonjë; <sup>28</sup> Sepse dotë mbaronjë e dotë shkurtonjë llogari me drejtëri, sepse Zoti dotë bënë llogari të-shkurtuarë mbi dhet." <sup>29</sup> Edhe sikundrë tha që përpara Isaia, "Zoti Savaoth të mos kishte lënë farë mbë ne, dotë ishimë bërë posi Sodhomatë, edhe dotë kishimë përgjaturë me Gomorratë."

<sup>30</sup> Ç'të themi pra? Se ata kombe që s'ndoqnë drejtëri, arritnë mbë drejtëri, mbë drejtërinë që është prej besësë; <sup>31</sup> Po Israili dyke ndjekurë nomn' e drejtërisë, ndë nomt të drejtërisë nuk' arriti. Përse? <sup>32</sup> Sepse nuk' **e ndiqte** me anë besë, po me anë të punëvet të nomit. <sup>33</sup> Sepse upenguanë ndë gurt të pengesësë; sikundrë është shkruarë, "Na tek vë ndë Sion një gur pengesë, edhe një shkëmp skandhalli, edhe kushdo që i beson ati nukë dotë turpëronetë."

## Krye 10

<sup>1</sup> Vëllezër, dëshërimi i zëmëresë s'ime, edhe lutja që **bënj** mbë Perëndinë për Israilinë, është për shpëtim **t'atyre**. <sup>2</sup> Sepse dëshmonj për ata, se u përvëltonetë zëmëra për Perëndinë, po jo pas kupëtimi të-drejtë. <sup>3</sup> Sepse dyke mos njohurë drejtërin' e Perëndisë, edhe dyke kërkuarë të ngrehënë drejtërin' e tyre, nuk' ubitnë ndë drejtërit të Perëndisë. <sup>4</sup> Sepse fundi i nomit është Krishti për drejtëri te cilido që beson.

<sup>5</sup> Sepse Moisiu shkruan për drejtërinë që është prej nomit, **dyke thënë**, "Se njeriu që bën këto, dotë rronjë me anë t'atyre." <sup>6</sup> Po drejtëria që është prej besësë thotë kështu, "Mos thuash ndë zëmëret t'ënde, Kush dotë hipënjë ndë qiellt?" do-me-thënë, që të sbresë Krishtinë; <sup>7</sup> A, "Kush dotë sbresë ndë pafundjet?" do-me-thënë, që të sjellë lart Krishtinë prej së-vdekurish. <sup>8</sup> Po ç'thotë? "Fjala është afërë teje, ndë gojë t'ënde e ndë zëmëret t'ënde;" do-me-thënë, fjala e besësë, që lëçismë; <sup>9</sup> Se ndë rrëfesh me gojë t'ënde Zotinë Jisu, edhe ndë besofsh ndë zëmëret t'ënde se Perëndia e ngjalli atë prej së-vdekurish, dotë shpëtonjë. <sup>10</sup> Sepse **njeriu** beson me zëmërë për drejtëri, edhe me gojë bënëtet rrëfim për shpëtim; <sup>11</sup> Sepse shkronja thotë, "Gjithëkush beson mb'atë, nukë dotë turpëronetë."

<sup>12</sup> Sepse s'ka të-çquarë ndër mest të Judheut e të Grekut; sepse gjithay Zot **është** i të-gjithëve, i-pasurë për gjith'ata që thërresënë mb'atë. <sup>13</sup> Sepse gjithëkush të thërresë mb'emërin' e Zotit, dotë shpëtonjë.

<sup>14</sup> Qysh pra dotë thërresënë mb'atë, të-cilit nuk' i besuanë? edhe qysh dot' i besonjë' ati për të-cilinë nukë kanë dëgjuarë? edhe qysh dotë dëgjonjëne, pa pasurë lëçitës? <sup>15</sup> Edhe qysh dotë lëçinjënë, ndë mos udërgofshinë? Sikundrë është shkruarë, "Sa të-bukura janë këmbët' e atyreve që apënë zën' e-mirë për paqtim, t'atyreve që apënë zën' e-mirë për të-miratë." <sup>16</sup> Po të gjithë nuk ubitnë ndë ungjillt, sepse Isaia thotë, "Zot, kush i besoj të-lëçiturit t'ënë?"

<sup>17</sup> Besa pra është prej dëgjimi; edhe dëgjimi me anë të fjalës' së Perëndisë. <sup>18</sup> Po them, Mos nukë dëgjuanë? Po, me të-vërtetë "zër' i atyreve doli mbë gjithë dhenë, edhe fjalët' e atyreve **vanë** gjer nd'anët të botësë." <sup>19</sup> "Po them," Mos nukë njohu Israili? I-pari Moisiu thotë, "Unë dot' u shtje juve ndë zili me anë t'atyre që nukë janë kombi **im**, edhe dot' u bënj juve të zëmërohi me anë një kombi që s'ka mënt." <sup>20</sup> Po Isaia kuxon edhe më tepërë e thotë, "U gjënçë tek ata që s'më kërkoninë, udukçë

mb'ata që nukë pyetninë për mua.”<sup>21</sup> Po Israilit i thotë, “Tërë ditënë shtrita duart’ e mia mbë një llaus që nukë bindet’ e flet kundrë.”

## Krye 11

<sup>1</sup> Them pra, Mos e hodhi tej Perëndia llauzin’ e ti? Qoftë lark; sepse edhe unë Israilit jam, prej farës’ s’Avraamit, prej degës’ së Veniaminit. <sup>2</sup> Perëndia nuk’ e hodhi tej llauzin’ e ti, të-cilin’ e njohu që përpara. Apo nukë dini ç’totë shkronja për llinë? qysh flet te Perëndia kundrë Israilit, dyke thënë, <sup>3</sup> “Zot, profitërit’ e tu i vranë, edhe theroret’ e tua i rrëzuanë; edhe unë mbeta i-vetëmë, edhe kërkonjëne jetënë t’ime.” <sup>4</sup> Po ç’i thotë përgjigja e Perëndisë? “Kam lënë për vetëhenë t’ime shtatë mijë burra, të-cilëtë nuk’ uunjnë mbë gjunjë përpara Vaalit.” <sup>5</sup> Kështu pra edhe ndë kohët të-tanishme ka mbeturë një mbetje pas të-sgjedhurit të hirit. <sup>6</sup> Edhe nd’ **është** prej hiri, nuk’ **është** më prej punërash; sepse **ndryshe** hiri nuk’ është më hir; sepse puna nuk’ është më punë. <sup>7</sup> Çë pra? Israili nuk’ e gjeti atë që kërkon; po të-sgjedhurit’ e gjetnë, edhe të tjerët’ uverbuanë, <sup>8</sup> (Sikundrë është shkruarë “Perëndia u dha atyre frymë të-dërmituri, sy që të mos shohënë, edhe veshë që të mos dëgjonjëne.”) gjer mbë ditët të-sotme. <sup>9</sup> Edhe Dhavidhi thotë, “Ubëftë truvez’ e atyre për kurth, e për lak e për pëngesë, e për çpagim mb’ata; <sup>10</sup> Uerrësoshinë syt’ e atyre për të mos parë; edhe kurrizin’ e atyreve kërrus-e për gjithënjë.”

<sup>11</sup> Them pra, Mos fëjyenë, që të rrëzonenë? Qoftë lark; po me anë të të-rrëzuarit t’atyre ubë shpëtim ndër kombet, që t’i shtjerë ata ndë zili. <sup>12</sup> Edhe ndë është të-rrëzuarët’ e atyreve pasje për botënë, edhe humbja e atyreve pasje për kombetë, sa më të-tepërë dotë jetë të-mbushurit’ e atyreve?

<sup>13</sup> Sepse juve kombevet u them, (gjersa jam unë apostoll i kombevet, lavduronj shërbesënë t’ime.) <sup>14</sup> Semos i shtije ndë zili ata që janë mishi im, edhe shpëtonj ca nga ata. <sup>15</sup> Sepse ndë **është** të-hedhurit’ e atyreve tej të-paqtuarë të botësë, **ç’tjetërë dotë jetë** të-priturit’ e atyre, përveç se jetë prej së-vdekurish.

<sup>16</sup> Edhe ndë është pem’ e-parë e-shënjtëruarë, **është** edhe **tërë** brumi; edhe ndë është rrënja e-shënjtëruarë, janë edhe degatë; <sup>17</sup> Po ndë ukëputnë ca nga degatë, e ti që ishnye ulli i-egrë ushartove ndër ato, edhe ubëre pjesëtar i rrënjësë edhe i të-majmit të drurit të ullirit, <sup>18</sup> Mos uburr kundrë degavet; edhe ndë mburresh, ti nukë mban rrënjënë, po rrënja **të mban** ty. <sup>19</sup> Dotë thuash pra, Ukëputnë degatë, që të shartonem unë. <sup>20</sup> Mirë; për pabesërinë ukëputnë, po ti qëndron me anë të besësë. Mos umbaj mbë të-lartë, po kij frikë; <sup>21</sup> Sepse Perëndia ndë mos kurseu degatë prej nature, **druaj** semos nukë kursenjë edhe ty.

<sup>22</sup> Shih pra mirësinë edhe ashpërimn’ e Perëndisë; mb’ata që urrëzuanë, ashpërimnë, edhe mbë ty, mirësinë, ndë qëndrofsh ndë mirësit; sepse **ndryshe** edhe ti dotë këputesh. <sup>23</sup> Kështu edhe ata, ndë mos qëndrofshinë ndë pabesërit, dotë shartonenë; sepse Perëndia është i-fuqishim propë t’i shartonjë ata. <sup>24</sup> Sepse ndë ukëpute ti nga ullir’ i-egrë prej nature, edhe kundrë naturësë ushartove ndë ulli të-butë, sa më tepërë këta që janë prej nature **dega** dotë shartonenë ndë ullit të tyre?

<sup>25</sup> Sepse nukë dua të mos dini, o vëllezër, këtë fshehtësirë, (që të mos mbahi të-mënçim ndër vetëhet t’uaj,) se ubë të-verbuarë mbë një pjesë të Israilit, gjersa të hynjë të-mbushurit’ e kombevet; <sup>26</sup> Edhe kështu gjithë Israili dotë shpëtonjë, sikundrë është shkruarë, “Dotë vinjë prej Sionësë ay që çpërblen, edhe dotë largonjë pabesëritë nga Jakovi. <sup>27</sup> Edhe këjo është nga ana ime dhjata mb’ata, kur të heq fajet’ e atyre.”

<sup>28</sup> Sipas ungjillit janë armiç për ju, po sipas të-sgjedhurit **janë** të-dashurë për atëritë. <sup>29</sup> Sepse dhurëtit’ edhe të-thërriturit’ e Perëndisë janë të-patundura.

<sup>30</sup> Sepse sikundrë edhe ju njëhere ishitë të-pabindurë te Perëndia, po ndashti

upërdëlytetë me anë të të-pabindurit të këtyreve; <sup>31</sup> Kështu edhe këta ndashti nuk' ubitnë, që me anë të përdëllimit **që utregua** mbë ju të përdë-llenë edhe ata.

<sup>32</sup> Sepse Perëndia i mbylli të-gjithë ndë pabindjet, që t'i përdëllenjë të-gjithë.

<sup>33</sup> O thellësirë pasjeje e urtësie e diturie Perëndie! sa të-pavëzhguarshim janë gjyqet' e tu, edhe sa të-pakupëtuarshime udhët' e tua! <sup>34</sup> Sepse "kush e njohu mëndjen' e Zotit? a kush ubë këshillës i ati?" <sup>35</sup> A "kush i dha gjë përpara, që t'i bënetë ati çpagim?" <sup>36</sup> Sepse prej ati, edhe me anë t'ati, edhe mb'atë janë të-gjitha; mb'atë qoftë lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.

## Krye 12

<sup>1</sup> U lutem pra juve, o vëllezër, për përdëllimet' e Perëndisë, të tregoni trupatë t'uaj kurban të-gjallë, të-shënjtëruarë, të-pëlqyerë te Perëndia, **që është** adhurimi juaj i-mënçim. <sup>2</sup> Edhe mos bëhi mbë një formë me këtë jetë; po ndërroni formënë t'uaj me anë të të-përsëriturit të mëndjesë s'uaj, që të provoni cili është i-miri, i-pëlqyeri edhe i-sosuri dashurim i Perëndisë.

<sup>3</sup> Sepse them, me anë t'ati hirrit që më është dhënë, mbë gjithë-sicilinë prej jush, të mos mendonjë **për vetëhen' e ti** më tepërë se sa gjan të mendonjë, po të mendonjë kështu, që të bënetë i-urtë, pas masës' së besësë që i ndau Perëndia gjithë-sicilit. <sup>4</sup> Sepse sikundrë ndë një trup kemi shumë anë, edhe gjithë anëtë nukë kanë gjithatë punë; <sup>5</sup> Kështu edhe **neve**, ndonëse jemi shumë, jemi një trup mbë Krishtinë, edhe gjithë-sicili jemi anë të njëri tjetrit. <sup>6</sup> Edhe kemi dhurëtira të-ndryshme pas hirrit që na udha; ndë **kemi** profiti, **letë profitepsmë** pas pjesës' së besësë **që na udha**; <sup>7</sup> Ndë shërbesë, **letë qëndrojmë** ndë shërbesët; kush është mësonjë, **letë epetë** pas mësimit; <sup>8</sup> Kush ka **dhurëtin'** e të dhënit këshilla, **letë apë** këshilla; kush ep nga e tia, **letë apë** me zëmërë të-thjeshtë; kush është i-parë, **letë jetë** i-parë me kujdes; kush përdëllen, **letë përdëllenjë** me buzë të-qeshurë.

<sup>9</sup> Dashuria letë mos jetë me dy faqe; kini cmir të-ligënë, e ngjituni pas së-mirësë.

<sup>10</sup> Doni fort njëri tjetërinë me dashuri vëllazërie; ndë të-nderuarë shkoni-e njëri tjetërinë; <sup>11</sup> Ndë punët të jini të-papërtuarshim; ndë shpirt të jini të-nxehtë; Zotit t'i shërbeni; <sup>12</sup> Ndë shpresët të gëzohi; ndë shtrëngim të duroni; ndë të-falurit të qëndroni; <sup>13</sup> Ndë nevojat të shënjtorëvet të ndihni; nga të-prituritë të-huajtë me miqësi mos hiqni dorë. <sup>14</sup> Bekoni ata që u ndjekën juve; bekoni e mos mallëkoni. <sup>15</sup> Gëzohi me ata që gëzonenë, edhe qani me ata që qanjënë. <sup>16</sup> Kini gjithata mendime ndër mest t'uaj; mos umbani mbë të-lartë po unjuni bashkë me të-përunjuritë; mos kujtoni vetëhenë t'uaj për të-mënçim.

<sup>17</sup> Asnjeriu mos i çpaguani të-keqe për të-keqe; kujdesuni për **punëra** të-mira përpara gjithë njerësvet. <sup>18</sup> Ndë mundetë, sa varetë nga ju, të kini paqtim me gjithë njerëzitë. <sup>19</sup> Mos merrni çpagim për vetëhenë t'uaj, o të-dashurë, po bëni udhë zëmërimit; sepse është shkruarë, "Imi është çpagimi; unë kam për të çpaguarë, thotë Zoti." <sup>20</sup> Ndë i arthtë uri pra armikut t'ent, ep-i të hajë; ndë i arthtë et, ep-i të pijë; sepse dyke bërë këtë dotë ngrumbullonç thëngjij **të-ndezurë** mbi kryet t'ati. <sup>21</sup> Mos umunt prej së-ligësë, po munt të-ligënë me të-mirënë.

## Krye 13

<sup>1</sup> Çdo shpirt letë unjë kryetë ndë pushtetet që janë përmbi atë; sepse nukë ka pushtet veç prej Perëndisë; edhe pushtetet që jan' urdhë-ruarë prej Perëndisë.

<sup>2</sup> Përandaj ay që rri kundrë pushtetit, i rri kundrë urdhërit të Perëndisë; edhe ata që rrinë kundrë, dotë marrënë dënim mbë vetëhet të tyre. <sup>3</sup> Sepse urdhëtarëtë nukë janë frikë për punërat' e-mira, po për të-ligatë. Do pra të mos i kesh frikë pushtetit? bëj të-mirënë, edhe dotë kesh lavdim prej ati. <sup>4</sup> Sepse urdhërtari është shërbëtuari i Perëndisë të ti për të-mirënë. Po ndë bëfsh të-ligënë, kij frikë; sepse

nuk' e mban mbë kot thikënë; sepse është shërbëtor i Perëndisë, çpajimmarrës që të mbushnjë zëmërimnë kundër ati që punon të-ligënë. <sup>5</sup> Përandaj është nevojë të unjni kryetë, jo vetëmë për zëmërimnë, po edhe për ndërgjegjenë. <sup>6</sup> Sepse për këtë paguani edhe pagesa, sepse janë shërbëtorë Perëndie, që shikonjënë këtë punë. <sup>7</sup> La-u-ni pra të-gjithëve detyratë; ati që i kini detyrë pagesë-në, pagesënë; **atiqë i kini detyrë** të-dhënatë, të-dhënatë; ati **që i kini detyrë** frikënë, frikënë; ati **që i kini detyrë** nderinë, nderinë.

<sup>8</sup> Asnjeri mos i kini detyrë asgjë, përveç se të doni njëri tjetërinë; sepse ay që do tjetërinë, ka mbushurë nominë. <sup>9</sup> Sepse porositë, “Mos kurvëronç, Mos vraç, Mos vjethç, Mos apç dëshmim të-rrem, Mos dëshëronç,” edhe çdo tjetëre porosi **që të jetë**, janë përmbledhurë ndë këtë fjalë, “Të duash të-afëriminë t'ënt posi vetëhenë t'ënde.” <sup>10</sup> Dashuria të-afërmit nuk' i bën keq; dashuria pra është të-mbushurit' e nomit.

<sup>11</sup> Edhe këtë, dyke diturë kohënë, se ndashti **është ora** të sgjonemi nga gjumi; sepse ndashti shpëtimi ynë **është** më afërë, se atëhere që be-suamë. <sup>12</sup> Nata uthye, e dita uafërua; letë hehëmë pra tej punët' e errësirësë, **edhe** letë veshmë armët' e dritësë. <sup>13</sup> Let' ecëjmë hieshim si ditënë; jo ndër lodrëtia e ndër të-dejtura, jo ndër shtrate **kurvërie** e ndër ndyrësira, jo ndër qarta e ndë cmir; <sup>14</sup> Po vishni Zotinë Jisu Krisht, edhe mos kini kujdes për mishinë **që t'i bëni** dëshërimetë.

## Krye 14

<sup>1</sup> Edhe atë që është i-dobëtë ndë besët, prit-e-ni **me të-mirë**, e jo me të-grindura për mendi-me. <sup>2</sup> Sepse një beson se **munt** të hajë **nga** të-gjitha, po ay që është i-dobëtë ha lakëra. <sup>3</sup> Ay që ha letë mos bënjë për asgjë atë që s'ha; edhe ay që s'ha letë mos gjykonjë atë që ha; sepse Perëndia e ka priturë. <sup>4</sup> Cili je ti që gjykon shërbëtorin' e-huaj? mbë zotin' e ti ay qëndron a bje; po dotë qëndronjë; sepse Perëndia është i-fortë t'a qëndronjë atë.

<sup>5</sup> Sepse një e çëmon një ditë më tepërë se një tjetëre ditë, e një tjetëre çëmon gjithë dittë si-një-një. Gjithë-sicili letë mendonëtë si i është mbushurë mëndja. <sup>6</sup> Ay që ruan ditënë, për Zotin' e ruan, edhe ay që nuk' e ruan ditënë, për Zotinë nuk' e ruan. Ay që ha, për Zotinë ha, edhe ay që nukë ha, për Zotinë nukë ha, edhe i faletë ndersë Perëndisë. <sup>7</sup> Sepse asndonjë prej nesh s'rron për vetëhen' e ti, edhe asndonjë s'vdes për vetëhen' e ti. <sup>8</sup> Sepse edhe ndë rrojmë, për Zotinë rrojmë; edhe ndë vdesmë, për Zotinë vdesmë. Edhe ndë rrojmë pra edhe ndë vdesmë, të Zotit jemi. <sup>9</sup> Sepse për këtë Krishti edhe vdiq (edhe ungjall) edhe rrojti përsëri, që të zotëronjë edhe mbi të-vdekurit' edhe mbi të-gjallëtë.

<sup>10</sup> Po ti përse gjykon vëllanë t'ënt? a edhe ti përse bën për asgjë vëllanë t'ënt? sepse ne të-gjithë dotë dalëmë përpara gjykatës' së Krishtit. <sup>11</sup> Sepse është shkruarë, “Rronj unë,” thotë Zoti, “se mua dotë më unjetë çdo gju, edhe çdo gjuhë dotë lavduronjë Perëndinë.” <sup>12</sup> Kështu pra gjithë-sicili prej nesh dot' i apë fjalë Perëndisë për vetëhen' e ti.

<sup>13</sup> Pra, letë mos gjykojmë më njëri tjetërinë; po gjykoni më tepërë këtë, të mos i vini vëllajt pëngesë, a skandhall. <sup>14</sup> E di edhe më është mbushurë mëndja mbë Zotinë Jisu, se prej vetiu s'ka asndonjë gjë të-ndyrë, veç për atë që mendon se ndonjë gjë është e-ndyrë, për atë është e-ndyrë. <sup>15</sup> Po ndë hidhëronëtë yt vëlla për të-ngrënëtë t'ënt, **ti** nukë ecën më pas dashurisë. Mos e bëj atë të humbasë për të-ngrënëtë t'at, **atë** për të-cilinë Krishti vdiq. <sup>16</sup> Letë mos shahetë pra e-mira juaj. <sup>17</sup> Sepse mbretëria e Perëndisë nuk' është të-ngrën' e të-pirë, po drejtëri e paqim e gëzim ndë Frymët të-Shënjtëruarë; <sup>18</sup> Sepse ay që i shërben Krishtit me këto, është i-pëlqyerë te Perëndia, edhe i-priturë te njerëzitë.

<sup>19</sup> Kështu pra letë ndjekmë ato që janë për paqtimnë, edhe ato që janë për të ndrequrë njëri tjetrinë. <sup>20</sup> Mos e prish punën' e Perëndisë për të-ngrënë. Të-gjitha janë të-qëruara; po është keq për njerinë që ha me skandhall. <sup>21</sup> Është mirë të mos hajë mish njeriu, as të mos pijë verë, as **të mos bënjë gjë**, mbë të-cilënë pengonet' a skandhaliset' a sëmuret' yt vëlla. <sup>22</sup> Ke ti besë? kij-e atë ndë vetëhet t'ënde përpara Perëndisë; lum ay që nukë dënon vetëhen' e ti mb'atë **gjë** që e gjen për të-mirë. <sup>23</sup> Po ay që është me dy mëndje, edhe ndë hëngrëtë, dënonetë; sepse nukë **ha** prej bese; edhe çdo gjë që nukë **bënetë** prej bese, është faj.

## Krye 15

<sup>1</sup> Edhe neve të-fortëtë kemi detyrë të mbajmë dobësirat' e atyre që janë të-dobëtë, e jo t'i pëlqejmë vetëhesë; <sup>2</sup> Po gjithë-sicili prej nesh let'i pëlqenj të-afërmit për të-mirënë, për ndre-qje. <sup>3</sup> Sepse edhe Krishti nuk' i pëlqeu vetëhes' së ti, po sikundrë është shkruarë, "Të-sharat' e atyreve që të shanjënë ty ranë mbi mua." <sup>4</sup> Sepse sa ushkruanë që më përpara, ushkruanë që më përpara për mësimnë t'ënë, që të kemi shpresë me anë të durimit e të ngushullimit të shkronja-vet. <sup>5</sup> Edhe Perëndia i durimit e i ngushullimit u dhëntë juve të keni gjithatë mëndje ndër mest t'uaj sipas Jisu Krishtit; <sup>6</sup> Që të lavduronit me një zëmërë e me një gojë Perëndinë edhe Atin' e Zotit t'ënë Jisu Krisht. <sup>7</sup> Përandaj pritni njëri tjetërinë, sikundrë edhe Krishti na priti për lavdi të Perëndisë.

<sup>8</sup> Edhe them, se Jisu Krishti ubë shërbëtuat i rrethpresjesë për të-vërtetën' e Perëndisë, që të vërtetonjë të-zotuarët mbë atëritë; <sup>9</sup> Edhe që të lavduronjënë kombetë Perëndinë për përdëllimn' **e ati**, sikundrë është shkruarë, "Për këtë dotë të lavduronj ndër kombe, edhe mb'emërinë t'ënt dotë psall." <sup>10</sup> Edhe përsëri thotë, "Gëzohi, o kombe, bashkë me llauzin' e ati." <sup>11</sup> Edhe përsëri, "Lavduronit Zonë, gjithë kombetë, edhe lëvdonit atë gjithë llauzetë." <sup>12</sup> Edhe përsëri Isaia thotë, "Dotë jetë rrënja e Jesseut," edhe "Ay që dotë ngrihetë që të mbretëronjë mbi kombet; mb'atë dotë shprenjënë kombetë."

<sup>13</sup> Edhe Perëndia i shpresësë u mbushtë juve me çdo farë gëzimi e paqtimi me anë të besësë, që të tepëroni ndë shpresët me anë të fuqis' së Frymës' së-Shënjtëruarë.

<sup>14</sup> Po edhe mua vetë, o vëllezër, më është mbushurë mëndja për ju, se edhe ju jeni plot me mirësi, të-mbushurë me çdo dituri, edhe se muntni të këshilloni njëri tjetërinë. <sup>15</sup> Po u shkruajta juve gjer mbë një shkallë më me kuxim, që t'u bje ndër mëntt, për hirinë që m'udha prej Perëndisë, <sup>16</sup> Që të jem shërbëtuat i Jisu Krishtit mbë kombet, dyke punuarë të shënjtëruarënë punë të ungjillit të Perëndisë, që të bënetë e-pëlqyerë dhurat' e kombevet **edhe** e-shënjtëruarë me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë. <sup>17</sup> Kam pra të-mburrurë mbë Jisu Krishtinë për punëratë që kanë të bëjnë me Perëndinë. <sup>18</sup> Sepse nukë dotë kuxonj të flas për ndonjë nga ato **punëra**, të-cilatë Krishti nukë bëri me anë t'ime, për të prurë ndë të-bindurë kombetë, me fjalë e me punë, <sup>19</sup> Me fuqi shënjash e çudirash, me fuqi të Frymës' së Perëndisë, kaqë sa që nga Jerusa-lemi e përqark e gjer ndë Ilirit e kam mbushurë **me** ungjillin' e Krishtit. <sup>20</sup> Edhe kështu upërpoqa të lëçis ungjillinë, jo ku ishte i-njohurë emër' i Krishtit, që të mos ndërtonj mbi themel të-huaj; <sup>21</sup> Po, sikundrë është shkruarë, "Ata, ndër të-cilët s'është dhënë zë për atë, dotë shohënë; edhe ata që s'kanë dëguarë, dotë kupëtonjënë."

<sup>22</sup> Përandaj edhe undaluashë shumë herë e s'erdha dot tek ju. <sup>23</sup> Po ndashti si s'kam më vënt ndëpër këto anë, edhe passi prej shumë vjeç kam mall të vinj tek ju, <sup>24</sup> Kur të vete ndë Spani, dotë vinj ndër ju; sepse shprenj dyke shkruarë **që aty** t'u shoh juve, edhe të përcillem prej jush për atje, passi të nginjem gjer mbë një shkallë me ju. <sup>25</sup> Po ndashti po vete ndë Jerusalim, për të-shërbyerë shënjtorëvet.

<sup>26</sup> Sepse Maqedhonia edhe Ahaia e gjetnë gjë të-pëlqyerë t'u bënë një ndihmë të-vobeqvet të shënjtorëvet që janë ndë Jerusolim. <sup>27</sup> Me të-vërtetë u pëlqeu **këjo**, edhe janë detorë ndër ata; sepse ndë ubënë kombetë pjesëtarë bashkë me ata ndë punërat të shpirtit, kanë detyrë t'u shërbenjënë atyreve edhe ndë punërat të mishit. <sup>28</sup> Si të mbaronj pra këtë, edhe t'u'a ap atyre me siguri këtë pemë, dotë shkonj nga ju për ndë Spani. <sup>29</sup> Edhe e di, se dyke ardhurë tek ju, dotë vinj me plotësirë të bekimit të ungjillit të Krishtit.

<sup>30</sup> Edhe u lutem juve, o vëllezër, me anë të Zotit t'ënë Jisu Krisht, edhe me anë të dashuris' së Frymës' së-Shënjtëruarë, të mundohi bashkë me mua dyke falurë Perëndisë për mua; <sup>31</sup> Që të shpëtonj nga ata që janë kundrësharë të besësë ndë Judhet, edhe që të jet' e-pëlqyerë mbë shënjtoretë shërbesa ime që po bënj për Jerusolimënë; <sup>32</sup> Që të vinj te ju me gëzim, ndë dashtë Perëndia, edhe të prëhem bashkë me ju. <sup>33</sup> Edhe Perëndia i paqtitim **qoftë** bashkë me ju të-gjithë. Amin.

## Krye 16

<sup>1</sup> Edhe u ndorëzonj juve Fivënë, motrënë t'ënë, që është shërbëtore e kishësë ndë Qenkreë; <sup>2</sup> Që t'a pritni mbë Zotinë sikundrë vëjen për shënjtoretë, edhe t'i ndihni asaj mbë çdo gjë që të ketë nevojë prej jush; sepse edhe ajo u ka ndihurë shumë vetave, edhe mua vetë.

<sup>3</sup> Ep-u-ni të-fala me shëndet Prisqillës' edhe Aqyllësë, bashkë-punëtorëvet të mi mbë Jisu Krishtinë, <sup>4</sup> (Të-cilëtë për jetënë t'ime vunë qafën' e tyre ndënë thikët; të-cilëvet u falem ndersë jo vetëm' unë, po edhe gjithë kishët' e kombevet;) <sup>5</sup> **Si** edhe kishësë që është ndë shtëpit' atyreve. Epni të-fala me shëndet të-dashurit t'im Epenet, i-cili është pem' e-parë e Ahaisë mbë Krishtinë. <sup>6</sup> Epni të-fala me shëndet Maria-mësë, e-cila shumë umundua për ne. <sup>7</sup> Epni të-fala me shëndet Andhronikut edhe Junisë, fare-fisavet të-mi e bashkë-skllëvërvet të-mi, të-cilëtë janë të-shënuarshim ndër mest t'apostojvet, të-cilëtë edhe më përpara se unë kanë qënë mbë Krishtinë. <sup>8</sup> Epni të-fala me shëndet Ampliut, të-dashurit t'im mbë Zotinë. <sup>9</sup> Epni të-fala me shëndet Urvanit bashkëpunëtorit t'ënë mbë Krishtinë, si edhe Staqiu të-dashurit t'im. <sup>10</sup> Epni të-fala me shëndet Apeliut të-provuarit mbë Krishtinë. Epni të-fala me shëndet atyreve **që janë prej shtëpis'** s'Aristovullit.

<sup>11</sup> Epni të-fala me shëndet atyreve **që janë** prej shtëpis' së Narqissit, atyreve që janë mbë Zonë. <sup>12</sup> Epni të-fala me shëndet Tryfenës' edhe Tryfosësë, të-cilatë mundonenë mbë Zotinë. <sup>13</sup> Epni të-fala me shëndet Rufit të-sgjedhurit mbë Zotinë edhe s'ëmës' s'ati, që është edhe imja. <sup>14</sup> Epni të-fala me shëndet Asinkritit, Flegondit, Ermajt, Patrovit, Ermiut, edhe vëllezërvet që janë bashkë me ata. <sup>15</sup> Epni të-fala me shëndet Fillollogut edhe Julisë, Nireut edhe motrës' s'ati, edhe Olimbaut, edhe gjithë shënjtorëvet që janë bashkë me ata. <sup>16</sup> Epni të-fala me shëndet njëri tjetërit me të-puthurë të-shënjtëruarë. U falemë me shëndet juve kishët' e Krishtit.

<sup>17</sup> Edhe u lutem juve, o vëllezër, të ruhi nga ata që bënë çarje e skandhali kundrë mësimi që kini nxënë ju, edhe të largoni nga ata. <sup>18</sup> Sepse të-tillët nuk' i shërbenjënë Zotit t'ënë Jisu Krisht, po barkut të tyre; edhe me fjalë t'ëmbëla e të-bukura gënjenjënë zëmërat' e atyreve që s'dinë ligësi. <sup>19</sup> Sepse të-binduritë t'uaj **ndë besët** arriti mbë të-gjithë. Sa për juve pra, gëzoni; edhe dua të jini të-diturë për të-mirënë, e të-miturë për të-ligënë. <sup>20</sup> Edhe Perëndia i paqtitim dotë dërmonjë Satanënë ndënë këmbët t'uaj për-së-çpejti. Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht **qoftë** bashkë me ju. (Amin.)

<sup>21</sup> U falemë me shëndet Timotheu bashkë-punëtori im, edhe Lluqiu e Jasoni e Sosipatri, farëfisasi' e mi.

<sup>22</sup> U falem me shëndet mbë Zotinë unë Tertiu që shkrova kartënë.

<sup>23</sup> U faletë me shëndet Gaiu, i-cili ka priturë mua me gjithë kishënë ndë shtëpit. U faletë me shëndet Erasmi kujdestari i qytetit, edhe vëllaj Kuart.

<sup>24</sup> Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht **qoftë** bashkë me ju. Amin.

<sup>25</sup> Edhe mb'atë që munt t'u forconjë juve pas ungjillit t'im edhe pas të-lëçiturit të Jisu Krishtit, pas sbulesës' së fshehtësirësë që qe ndënë heshtje prej motesh të-përjetëshm, <sup>26</sup> Po tani uçpërfaq, edhe me anë të shkronjavet të profitërvet, pas urdhërit të të-përjetëshmit Perëndi, unjoh mbë gjithë kombetë, që t'i bindenë besësë; <sup>27</sup> Mbë të-vetëminë e të-diturinë Perëndi **qoftë** lavdia me anë të Jisu Krishtit për gjithë jetënë. Amin.